



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT
OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN

P.nr.1794/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shpresa Emra me pjesëmarrjen e sekretares juridike - procesmbajtëses Birsën Shoshani, në çështjen penale kundër të pandehurit R. G. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 pika 1.4 të KP-së, duke vendosur sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.934-4/2016 të datës 26.08.2016, jashtë shqyrtimit gjyqësor me datë 25.08.2017, morri këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.934-4/2016 e datës 26.08.2016 dhe kjo gjykatë në kuptim të dispozitave të nenit 495 të KPP-së jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit R. G., nga i ati Q., e ëma F., i lindur me datë 22.08.1948 në Prizren, me banim në Rr. " " nr., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, pensionist, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 15.04.2016, rreth orës 23:00 minuta, në Prizren në rrugën pikërisht në shtëpinë e tij, i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin të dëmtuarës – bashkëshortes së tij N. G., në atë mënyrë që derisa e njëjta ishte duke përgatitur ushqim, i pandehuri ia ndërprente rrymën, ashtu që e dëmtuara reagon se po përgatiste ushqim, i pandehuri i inatosur e sulmon duke e goditur me këpucë me ç rast i shkakton lëndime trupore në pjesën e kokës dhe krahut të majtë, lëndime këto më afër të konstatuara në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, dr. N. H.; të dhënë me dt. 04.07.2016.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 pika 1.4 të KP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 41, 42, 43, 46, 73 dhe nenit 188 paragrafi 3 lidhur me nën paragrafi 1.4 të KP-së i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Të pandehurit Raif Grosha i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësinë prej 200 (dyqind)€, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, gjykata këtë dënim do t'ia zëvendësoj të pandehurit me dënim me burgim duke llogaritur 20 Euro për një ditë burgimi, respektivisht me 20 (dhjetë) ditë burgim.

E dëmtuara N. G. nga Prizreni, udhëzohet në kontest të rregullt civil - juridik lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e kësaj procedure penale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20.88€ dhe paushallin gjyqësorë në shumë prej 20 €, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar Aktakuzë PP/II.nr.934-4/2016 me datë 26.08.2016, ndaj të pandehurit R. G. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 pika 1.4 të KP-së dhe gjithashtu ka kërkuar që gjykata pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor të jep **URDHËR NDËSHKIMOR** me të cilin të akuzuarit do ti shqiptohet dënimi me gjobë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari në harmoni me dispozitat e nenit 495 të KPP-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPP-së dhe në harmoni me nenin 495 paragrafi 1 të KPP-së, vendosi që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjykata konsideron se provat e bashkëngjitura në shkresat e lëndës si: raporti mjekësor i Spitalit Regjional në Prizren - Qendra emergjente, me numër të protokollit 2957, ekspertizën mjeko-ligjore, Dr. Naim Haliti të datës 04.07.2016 në emër të lënduarës N. G., raporti i oficerit nr. 2016-GA-0969, të dt. 16.04.2016, deklarata e të pandehurit dhe të dëmtuarës si dhe shkresat e tjera të bashkëngjitura në lëndë janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i akuzuari është kryerësi i veprës penale për të cilën akuzohet.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrur në kuptim të dispozitave të nenit 463 të KPP-së.

Vendimi mbi paushallin gjyqësorë (shpenzimet procedurale) është marrur në kuptim të dispozitave të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së.


Me sa u tha më lartë, në kuptim të dispozitave të nenit 495 të KPP-së, u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.1794/2016 datë 25.08.2017

Sekretare Juridike

Birsen Shoshani



UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit.